REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 03.11.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	**KRASNIQI**	**Kryetar**
Desada	**METAJ**	**Zëvendëskryetar**
Aurela	**BICJA**	**Anëtar**
Besian	**ZOGAJ**	**Anëtar**
Gjergji	**HAMITI**	**Anëtar**
Jetmir	**HALILAJ**	**Anëtar**
Joana	**ALLUSHI**	**Anëtar**

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Heqjen e autorizimit të subjektit person fizik "Emiljano Hoxhaj", për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, mbështetur në rrjet kabllor "Glob TV". **(Vendim nr. 118, datë 03.11.2026)**
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë "TV Berati" sh.p.k., për subjektin audioviziv privat lokal "TV Berati", për një periudhë 8 (tetë) vjeçare. **(Vendim nr. 119, datë 03.11.2026)**
3. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Radio Saranda" sh.p.k, për subjektin audio privat lokal "Radio Saranda", për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare. **(Vendim nr. 120, datë 03.11.2026)**
4. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Artan Zhiva, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Inkusat", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendim nr. 121, datë 03.11.2026)**
5. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë "VANI" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Mati", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendim nr. 122, datë 03.11.2026)**
6. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 34, datë 01.06.2026 të vendosur ndaj shoqërisë "Panorama TV" sh.p.k. **(Vendim nr. 123, datë 03.11.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 03 nëntor 2026